

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

I DETYRUAR

VARIANTI **A**

E mërkurë, 1 qershor 2011

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme artistike; koreografike; sportive; me kohë të shkurtuar

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në dramë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9a	9b	10a	10b	10c	11a	11b	11c
Pikët																
Kërkesa	12a	12b	12c	13a	13b	13c	13d	14	15	16	17	18	19	20a	20b	20c
Pikët																
Kërkesa	21a	21b	21c	22a	22b	22c	23a	23b	24a	24b	24c	25a	25b	25c		
Pikët																

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****Ismail Kadare****Fund Vjeshte**

Autobusët urbanë nga periferitë  
Drejt qendrës mbi qelqe sjellin brymën.  
Vjeshta si luaneshë krifëverdhe  
Ruan ditët e fundit nga dimri.

Te vitrinat, te dyert e kafeve,  
Kalimtarë të shumtë ka.  
Në reflekset e flokëve të tu  
Një nuancë e kuqërremtë ra.

Pranë ditëve të tua të bardha  
Kalova sot rastësisht.  
Ti u trembe? Unë ujk nuk jam,  
(As dele nuk jam, natyrisht).

Po ti eja, atje të shkojmë,  
(Pa përfillur fjalët e botës),  
Ku nga avulli xhamat e kafeve  
Ngjajnë si pamje që s'janë në fokus.

N'autobusët urbanë eja,  
Të shkojmë periferive me brymë.  
Të shikojmë si vjeshta krifëverdhe  
Ruan ditët e fundit nga dimri.

---

*Për pyetjet 1-7 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.*

1. Krijimi i Kadaresë *Fund Vjeshte* është një lirikë:

**1 pikë**

- A) filozofike
- B) sociale
- C) atdhetare
- D) intime

2. Në këtë poezi poeti pranëvendos:

**1 pikë**

- A) stinën dhe gjendjen shpirtërore të heroit
- B) dy dukuri natyrore
- C) ndjesi të ndryshme tek i njëjti njeri
- D) dy pamje në periferi të qytetit

3. Vargjet: *Ti u trembe? Unë ujk nuk jam, / (As dele nuk jam, natyrisht)*, sjellin nota: **1 pikë**

- A) urrejtjeje
- B) trishtimi
- C) humori
- D) frike

4. Pjesë e leksikut të poezisë së Kadaresë, që ndeshet edhe në krijime të tjera të tij, janë fjalët: **1 pikë**

- A) qelqe, flokët
- B) sjell, ruan
- C) qendër, kalimtarë
- D) ditët, dyert

5. Mendimi se heroi lirik ngrihet mbi mentalitetin e kohës del në vargun: **1 pikë**

- A) Kalimtarë të shumtë ka.
- B) Pa përfillur fjalët e botës.
- C) Kalova sot rastësisht.
- D) Ngjajnë si pamje që s'janë në fokus.

6. Përsëritja e shprehjes: *autobusët urbanë*, sjell në poezi: **1 pikë**

- A) dobësi dhe mall
- B) qetësi dhe paqe
- C) ikje dhe harresë
- D) lëvizje dhe gjallëri

7. Në sintagmën *Fund vjeshte*, fjala e dytë ka funksionin: **1 pikë**

- A) e rrethanorit
- B) e përcaktorit
- C) e kundrinorit
- D) e kryefjalës

8. Në strofën e parë, gjeni detajin që jep atmosferën e fundvjeshtës. **1 pikë**

---

9. Shpjegoni nëntekstin në vargun: *Pranë ditëve të tua të bardha*. Dalloni figurën letrare të përdorur nga autori për të realizuar këtë nëntekst.

a) Nënteksti: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

---

b) Figura letrare: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

**10.** Identifikoni llojin e rimës dhe të strofës në këtë poezi. Ç'fiton poezia e Kadaresë nga ky organizim metrik?

- a) \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- b) \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- c) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

**11.** Ndaluni në strofën e tretë dhe të katërt.

Zbuloni mjetin gjuhësor me anë të të cilit tregohet që heroi lirik nuk është vetëm.  
Ç' marrëdhënie vendos heroi me dialoguesin? Ilustrojeni me një shembull nga poezia.

- a) \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- b) \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- c) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

**12.** Tregoni llojin e fjalëformimit të fjala “*krifëverdhe*”. Gjeni në poezi fjalën që formon sinonimi kontekstuale me të.

Shpjegoni imazhin që kjo fjalë transmeton te lexuesi.

- a) fjalëformimi: \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- b) sinonimi: \_\_\_\_\_ **1 pikë**
- c) shpjegimi: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

\_\_\_\_\_



**PJESA II****Euripidi****Medea  
(fragment)****Kori**

Grua fatkeqe!  
Medet! Medet!  
Je një e mjerë  
me dhembje plot!  
Nga t'ia mbash?  
Tek cili mik,  
ose shtëpi,  
në ç'tokë vallë  
ke për të gjetur  
shpëtim nga vuajtjet?  
Në këtë dallgë  
aq të tmeruar  
dhe plot mjerime,  
nonjë nga hyjtë  
Mede, të hodhi.

**Medea**

Keq për mua punët nga të gjitha anët;  
kush do thotë "jo"?  
Po kështu nga Hera - mos besoni kurrë -  
s'kanë për të shkuar.  
Ka akoma luftëra për nusen e dhëndrin,  
dhembje, hidhërimi për vjehërën e vjehrin.

A kujton se unë këtij nonjë herë  
do t'i flisnja fjalë me përgëdheli,  
po të mos shpresonja të fitoja diçka  
ose t'i kurdisnja mirë nonjë plan?  
Jo, nuk do t'i flisnja, as edhe me dorë  
nukë do ta preknja. Po ky është bërë  
aqë i çkalluar, sa që ndonse mundte  
të më nxirrte jashtë nga ky vend këtu  
dhe t'i prishte fare planet që kam bërë,  
për sot më dha leje të qëndroj këtu;  
sot të tre armiqtë do t'i shtrij të vdekur:  
atin me të bijën edhe burrin tim.  
Kam shumë mënyra shpirtin t'ua marr,  
po s'e di, moj shoqe, cilën nga këto  
të përdor më parë; s'di se si të bëj:

-----  
Hajde, pra, Mede!

Mos lë pa përdorur gjith' ato mënyra  
që i ke mësuar; ecë gjer në fund;  
ja kjo është dita që kërkon kurajë.  
Nuk shikon se ç'vuan? Dasma e Jasonit,  
dasm' e Sisifidve, s'duhet kursesi  
të t'bëj qesharake, ty që ke një atë  
tepër të dëgjuar, që ke stërgjysh Djellin.  
A po s'je e ditur?

*Për pyetjet 14-19 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.*

**14.** Medea është vepër e gjinisë:

**1 pikë**

- A) epike
- B) lirike
- C) liriko-epike
- D) dramatike

**15.** Medea shtron si zgjidhje për problemin e saj:

**1 pikë**

- A) hakmarrjen
- B) marrëveshjen
- C) harresën
- D) përshtatjen

16. Fjala *medet* është: **1 pikë**

- A) krahasim
- B) pyetje retorike
- C) hiperbolë
- D) pasthirmë

17. Togfjalëshi *Grua fatkeqe!* formohet nga: **1 pikë**

- A) mbiemër + përemër
- B) folje + ndajfolje
- C) emër + mbiemër
- D) emër + përemër

18. Mesazhi që përcjell Euripidi në këtë vepër është: **1 pikë**

- A) Urreni dëshirën për pushtet.
- B) Mbroni virtytet në shërbim të familjes.
- C) Admironi çdo lloj pasioni.
- D) Mësojuni fëmijëve aftësinë për të falur.

19. Medea, mbushur plot urrejtje, shfaqet më mirë te shprehja: **1 pikë**

- A) kam shumë mënyra, shpirtin tua marr.
- B) keq për mua punët nga të gjitha anët.
- C) do t'i flisnja me fjalë, me përkëdheli.
- D) ose t'i kurdisnja mirë ndonjë plan.

20. Si e vlerësoni situatën që përjeton Medea në këtë fragment? Jepni dy arsye pse ajo është e tillë.

a) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

c) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

21. Ç'qëndrim mban kori në këtë fragment? Gjeni togun e fjalëve që mban peshën kuptimore të mesazhit që përcillet nga ai.

Nisur nga fjalët e fundit të korit, tregoni se prej kujt varej dhe drejtohej fati i personazheve në veprat e antikitetit?

a) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

c) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

22. Konflikti është një nga veçoritë e kësaj vepre.

Cili është mekanizmi që vë në lëvizje konfliktin dhe i jep intensitet atij? Vini në dukje pikën kulmore të këtij dramaticiteti në këtë fragment dhe shpjegoni pse ajo konsiderohet e tillë.

a) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

\_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

c) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

\_\_\_\_\_

23. Veçoni fjalën kyçe që tregon se Medea do të veprojë shpejt në vargun: *sot të tre armiqtë do t'i shtrij të vdekur*. Ç' pjesë e ligjëratës është ajo?

a) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

24. Nxirrni nga fragmenti tri momente që japin gjendjen dhe zhvillimin psikologjik të Medeas.

a) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

c) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

25. Vepra *Medea* vazhdon të pëlqehet edhe sot e kësaj dite. Një nga arsyet është se personazhet e Euripidit paraqiten siç janë në realitet.

Zbuloni dy tipare të Medeas në këtë fragment që kanë lidhje me këtë pohim. Argumentoni zgjidhjen që autori i jep fatit të saj në fund të veprës.

a) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

c) \_\_\_\_\_ **1 pikë**